

KUD 338.23:336.2

NDIKIMI I SHTETIT LIGJOR NË STABILIZIMIN EKONOMIK DHE SOCIAL

Mentor Kaçi

Abstrakt

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të diskutojmë rreth rolit që ka luajtur politika ekonomike dhe sociale në stabilizimin makroekonomik si një parakusht për një rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe roli i saj në zhvillimin ekonomik veçanërisht në rolin që ka ajo në krijimin e një mjedisi makroekonomik të qëndrueshëm. Zgjedhja e politikës fiskale është një nga çështjet më të debatueshme të rolit të qeverisë në jetën ekonomike e sociale të një vendi. Në këtë trajtim do të analizojmë disa nga çështjet mbi të cilat debati rreth politikës fiskale në vendin tonë mbetet i hapur.

Hyrje

Politika fiskale është përdorimi i shpenzimeve që kryen një qeveri për të ofruar të mira e shërbimeve dhe mënyrës se si qeveria financon këto shpenzime. Ekzistojnë dy metoda kryesore të financimit: nëpërmjet taksimit dhe huamarrjes. Gjithashtu qeveritë mund të financojnë shërbimet e tyre edhe nëpërmjet të ardhurave të grumbulluara nga shitja e pronës publike ashtu edhe nga pagesat direkte që vendosen për çdo shërbim publik. Financimi nëpërmjet borxhit (huamarrjes) si një mënyrë e ofrimit të shërbimeve publike është një komponent i rëndësishëm i politikës fiskale.

Politika fiskale mund të jetë ekspansioniste ose shtrënguese. Një politikë fiskale ekspansioniste do të thotë shkurtim i taksave direkte dhe indirekte si dhe rritja e shpenzimeve qeveritare. Këto politika do të inkurajojnë më shumë shpenzimet dhe do të ndikojnë në rritjen e aktivitetit ekonomik.

Politika e uljes së taksave dhe rritjes së shpenzimeve qeveritare çon në dobi të rritjes së kërkesës agregate, e cila këshillohet të ndiqet gjatë periudhave të rënies ekonomike.

Ndjekja e një politike të tillë ku qeveria luan një rol aktiv në stimulimin e ekonomisë gjatë periudhave të rënies dhe ulja e shpenzimeve qeveritare gjatë periudhave të rritjes (bumit) njihet si shkolla e mendimit Keynesian.

Një politikë fiskale shtrënguese do të thotë rritje taksash si dhe shkurtim të shpenzimeve qeveritare.

Këto politika do të reduktojnë nivelin e kërkesës agregate dhe ndihmojnë në uljen e inflacionit. Të zgjedhësh midis këtyre dy tipeve të

=====
politikës fiskale është një vendim i vështirë, si përsa i përket gjëndjes aktuale të ekonomisë, ashtu edhe vendimeve politike.

Në këtë temë do të trajtohen disa nga çështjet mbi të cilat debati rreth politikës fiskale mbetet i hapur.

Kjo temë përbëhet nga tre seksione.

Në seksionin e parë do të trajtohet ndikimi fiskal në stabilizimin makroekonomik i cili përbën një kusht për gjallerimin dhe rritjen e ekonomike.

Analiza do të fokusohet si në trajtimin teorik ashtu edhe në rolin që ka lujtur politika fiskale në vendin tonë.

Seksioni i dytë do të jetë pjesa më e rëndësishme e temës duke analizuar rolin e politikës fiskale në stabilizimin makroekonomik. Ky seksion do të analizojë disa nga treguesit kryesor makroekonomik në këndvështrimin të qëndrueshmerisë makroekonomike: roli që luan politika fiskale në zbutjen e luhatjeve të zhvillimit ekonomik, ndikimi i saj në qëndrueshmerinë fiskale, roli që luan ajo në politikatat rishpërndarëse nga një grup shoqëror tek një tjetër etj.

Debatet mbi politikat fiskale janë mjaft të gjëra, si përsa i përket nivelit të taksave, strukturës së tyre, gamës së shërbimeve publike të ofruar nga shteti, struktura e shpenzimeve publike, nivelit të borxhit publik, ashtu edhe ndërhyrjes së shtetit nëpërmjet enteve rregulluese.

Disa nga aspektet e këtyre debateve do të trajtohen në këtë seksion.

Tema mbyllet me konkluzionet.

Politika fiskale dhe rritja ekonomike

Në periudhë afatshkurtër gjendja e ekonomisë mund të karakterizohet me një nga katër fazat e ciklit të biznesit kurse në periudha afatgjata ajo karakterizohet nga tendenca drejt rritjes ekonomike. Rritjen ekonomike mund ta përcaktojmë si një ekspansion në GDP potencial të një vendi. Me fjalë të tjera, rritja ekonomike përcaktohet si aftësi e ekonomisë së një vendi për të prodhuar gjithnjë e më shumë mallra e shërbime që dëshirojnë konsumatorët.

Lidhja makroekonomike midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike për shumë kohë ka qenë në qendër të vëmendjes së ekonomistëve.

Tre janë treguesit kryesorë të politikës fiskale: shpenzimet qeveritare, taksat dhe deficitet buxhetor.

Asnjë nga këta komponentë të politikës fiskale nuk tregon një korrelacion të fortë me rritjen ekonomike kur analizohen të ndarë nga njëri-tjetri, pasi asnjë prej tyre nuk përfaqëson plotësisht pozicionin e politikës fiskale.

Një rol të rëndësishëm që luan politika fiskale në rritjen ekonomike është ndikimi që ka ajo në stabilizimin makroekonomik.

Një ekonomi me një mjedis makroekonomik të paqëndrueshëm, do të ndikojë në reduktimin e prodhimit.

Një nga treguesit me ndikim të ndjeshëm në luhatshmerinë e prodhimit është niveli i ndryshueshmerisë së çmimeve. Një ekonomi me një norme inflacioni të paqëndrueshëm dhe të lartë do të rris koston e biznesit duke ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik. Politika fiskale mund të ndikojë nivelin e inflacionit si nëpërmjet nivelit të taksave ashtu edhe nëpërmjet nivelit të konsumit publik dhe nivelit të deficitit buxhetor.

Luhatshmeria e politikës fiskale ndikon ndjeshëm në luhatshmerinë e nivelit të inflacionit me një efekt negativ në nivelin e prodhimit.

Politika fiskale dhe ciklet e biznesit


Treguesi kryesor mbi të cilin vlerësohet ecuria ekonomike e një vendi është Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), i cili është një matës agregat i vlerës së të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare që prodhohen në një vend brenda një viti.

Në teorinë ekonomike sjellja e rritjes së PBB njihet me termin ciklet e biznesit.

Sjellja e PBB gjatë kohës zakonisht shfaqet në formë vale, e cila ka katër karakteristika (faza):

1. kulmi (pika me e lartë)
2. renia (recesioni)
3. minimumi
4. rritja (ekspansioni).

Figura 1: Pamje e Ciklit të Biznesit



Momenti kyç, për të identifikuar një cikël të biznesit, është përcaktimi i fazës së recesionit pra, përcaktimi i periudhës kur aktiviteti ekonomik është në rënie.

Kemi të bëjmë me një fazë të recesionit ekonomik vetëm atëherë kur GDB real bie gjatë dy tremujoreve të njëpasnjëshëm.

=====

Gjatë periudhës së rënies firmat dhe konsumatorët i ulin nivelin e shpenzimeve të tyre. Firmat për shkak të inventareve të tepërta (stokeve të mallrave të pashitura), reduktojnë prodhimin, pakësojnë shpenzimet për lëndë të para, reduktojnë shpenzimet për investime, dhe nxjerrin nga puna një numër të caktuar punonjeshish.

Rrjedhimisht, fitimet e firmave bien, por edhe në këto kushte disa firma qëndrojnë në biznes, kurse disa të tjera falimentojnë. Rritja e papunësisë ndikon në rënie të mëtejshme të produktit duke e keqësuar me tej situatën.

Kur ekonomia arrin në piken minimum ekonomia përballet me një nivel të lartë papunësie dhe një nivel të ulët të inflacionit. Niveli i ulët i inflacionit është pasojë e një niveli të ulët të kërkesës agregate.

Kur ekonomia fillon dhe rritet, njerezit konsumojnë më shumë duke inkurajuar prodhuesit të prodhojnë më shumë. Kjo do të thotë më shumë punë, e cila ndikon në rritjen e nivelit të shpenzimeve dhe në nivelin e mirëqënies.

Kur ekonomia funksionon për një kohë të gjatë në mënyrë të suksesshme, lëndet e para do të konsumohen, puna e kualifikuar do të bëhet e pamjaftueshme dhe inventaret në magazina do të rriten. Kjo do të shkaktojë reduktimin e numrit të të punësuarve në kompanitë e ndryshme, duke ndihmuar në ardhjen e recesionit, i cili është i paevitueshëm edhe kur ekonomia nuk përballet me ndonjë shock negativ.

Sipas shkollës Keynesiane, politika fiskale operon si një stabilizues automatik i luhatjeve të prodhimit duke ndikuar në zbutjen e cikleve të biznesit edhe pse ato shfaqen si një dukuri normale e zhvillimit ekonomik.

Luhatja e prodhimit ndikon direkt treguesit fiskal, si nivelin e të ardhurave nga taksat ashtu edhe nivelin e shpenzimeve qeveritare.

Kështu gjatë një rënie ekonomike, shpenzimet qeveritare për subvencionimin e papunësisë, rriten automatikisht si pasojë e rritjes së nivelit të papunësisë.

Gjithashtu edhe niveli i taksave që paguajnë konsumatorët dhe bizneset do të ulët si pasojë e uljes së prodhimit mbi të cilin vendosen këto taksa. Pra automatikisht efekti në kërkesën agregate si pasojë e rënies ekonomike do të zvogelohet për shkak të stabilizuesve automatik.

Në rastin tonë, rritja e subvencionit të papunësisë do të lehtësojë efektin negativ në konsumin e të papunëve dhe ulja e tatimeve i ndihmon konsumatorët të mos ulin ndjeshëm konsumin.

Megjithatë, në kushtet kur balanca fiskale (të ardhurat minus shpenzimet) duhet të ruhet, gjatë rënies ekonomike rënia e të ardhurave tatimore duhet të shoqërohet me rënie të shpenzimeve publike.


Gjatë rënies ekonomike ky shkurtim i shpenzimeve publike do ta përkeqësojë këtë rënie. Në mënyrë që të ndalohet rënia ekonomike,

ndërhyrja në ekonomi nëpërmjet një politike fiskale ekspansioniste vlerësohet e rëndësishme në frenimin e kësaj renie.

Qëllimi i politikës fiskale është rritja e kërkesës agregate dhe e prodhimit në menyrë direkte, nëpërmjet rritjes së shpenzimeve qeveritare, ose në mënyrë indirekte, nëpërmjet reduktimit të taksave që stimulojnë konsumin privat dhe rritin investimet.

Në figurë paraqitet grafikisht efekti i një politike fiskale ekspansioniste, ku me P janë shënuar çmimet, AD kurba e kërkeses agregate, AS kurba e ofertës agregate dhe PBB prodhimi i brëndshëm bruto.

Figura 2: Efekti i nje politike fiskale ekspansioniste



Ndjekja e një politike fiskale ekspansioniste kur kemi rënie ekonomike, do të rezultojë me rritje të deficitit buxhetor, i cili mund të prodhojë efekte negative në qëndrueshmerine fiskale.

Megjithate, teoria Keynesiane pretendon që rritja e kërkesës agregate do të rrise investimet, të cilat prodhojnë rritje ekonomike në të ardhmen duke rritur kështu të ardhurat buxhetore të cilat do të jenë të afta të shlyejnë borxhin publik.

Sipas një studimi të kryer nga FMN, rezulton që në vendet me nivel të ulët të të ardhurave për frymë ku bën pjesë edhe vendi ynë, kanali me të cilin politika fiskale ndikon rritjen ekonomike nuk janë investimet por rritja e produktivitetit të faktoreve të prodhimit.

=====

Politika fiskale dhe qendrueshmeria fiskale

Përveç rolit të saj në zbutjen e luhatjeve të zhvillimit ekonomik, zgjedhja e politikës fiskale duhet të mbajë në konsideratë edhe ndikimet në qëndrueshmerinë fiskale. Një politikë fiskale e qëndrueshme do të thotë që borxhi publik në termat e Produktit të Brëndshëm Bruto (PBB) nuk ka prirje pozitive.

Qëndrueshmëria fiskale ka të bëjë me aftësinë e qeverisë për të financuar shërbimet publike dhe për të paguar ose kthyer borxhin publik.

Një kriter tjetër për të vlerësuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është edhe kushti që norma e parashikuar e rritjes së borxhit publik duhet të jetë me e vogël se norma e interesit gjatë një periudhe afatgjate.

Sipas FMN (2002) politikat ekonomike mund të klasifikohen si të paqëndrueshme në qoftë se ato çojnë në një situatë ku në të ardhmen qeveria nuk mund të financojë shërbimet publike. Në fakt aftësia e qeverisë për të financuar shërbimet publike është një kusht i nevojshëm i qëndrueshmerisë fiskale për shkak se financimi i shërbimeve publike mund të arrihet me kosto shumë të larta (rritja e taksave). Qëndrueshmëria fiskale, kërkon ruajtjen e aftësisë së qeverisë për të financuar shpenzimet publike pa ndryshuar politikat fiskale. Si përfundim, një politikë është e qëndrueshme në qoftë se "parashikohet që një huamarrës është i aftë të vazhdojë të paguajë borxhin e tij pa ndryshime të mëdha në të ardhmen në mënyrë që të balancojë të ardhurat dhe shpenzimet".

Një politikë fiskale do të vlerësohet e qëndrueshme në qoftëse ajo plotëson dy kushte: (i) qeveria përmbush detyrimet/kërkesat korrente të buxhetit duke paguar/kthyer borxhin dhe nuk monetizon (financon nëpërmjet emetimit të parave nga Banka Qëndrore) ate, dhe (ii) një vend/qeveri nuk vazhdon të rrisë nivelin e borxhit publik duke ditur që në të ardhmen do të kërkojnë ndërhyrje me kosto të larta në mënyrë që të paguhet/kthehet borxhi. Treguesi më i lehtë për të vertetuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është norma e borxhit publik ndaj produktit të brëndshëm bruto, ose ndryshe norma borxh-të ardhura. Një normë borxhi publik në rritje do të thotë që politika fiskale po bëhet e paqëndrueshme. Sipas Blanchard (1990), norma e borxhit të një ekonomie mund të vlerësohet nëse është në rritje apo jo duke u bazuar në formulën : $\Delta b = b(r - y) - z > 0$, kur 'r' paraqet normën reale të interesit ose e përshtatur me inflacionin (normë nominale minus inflacion); 'z' paraqet balancën primare (të ardhurat minus shpenzimet pa interesa) të buxhetit të shtetit ndaj PBB; 'y' paraqet normën e rritjes së PBB dhe 'b' normën e borxhit ndaj PBB (Δb – ndryshimin e normës së borxhit). Pra norma e

borxhit publik ndaj PBB është në varesi të normës reale të interesit, normës së rritjes ekonomike dhe balancës primare të buxhetit të shtetit. Sa më e lartë të jetë norma e interesit dhe sa më e ulët norma e rritjes ekonomike aq më shumë ka mundësi që norma e borxhit të rritet.

Mbështetur mbi parimet e kësaj formule janë përcaktuar edhe kriteret e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike (PSRrE), nënshkruar në vitin 1997 si element i Traktatit të Maastricht. Sipas këtyre kriterëve, vendet e Bashkimit Evropian nuk lejohet të kalojnë nivelin e borxhit publik mbi 60% të PBB dhe deficitit buxhetor nuk duhet të jetë më i lartë se 3% e PBB. Tashmë kritikata ndaj kriterëve të PSRrE janë të shumta duke kërkuar që ai të rishikohet dhe të ndryshohet në dobi të zhvillimit ekonomik.

Kriteri i Paktit të Stabilitetit në lidhje me nivelin e deficitit buxhetor që të mbahet nën nivelin 3% e PBB, (përveç “rasteve të veçanta”, të tilla si një rënie në rritjen ekonomike më shumë se 2%), nuk janë respektuar nga vendet anetare. Në rastet kur nuk respektohen kriteret e tij përbën një politikë denimi, e cila nuk është përdorur asnjëherë. Edhe politika e denimit (në rastet kur kriteri i deficitit kalohet, ai vend është i detyruar të vendosë një depozit pa interes, - 0.2-0.5% e PBB, në llogari të Komitetit Evropian, dhe në qoftë se ky kriter nuk përmbushet brenda 2 viteve atëherë kjo depozitë do të kthehet në gjobë) të Paktit është kritikuar nga një numër i konsiderueshëm ekonomistësh dhe analistësh. Kjo politikë nuk është kredibël pasi ajo vendoset pas tre viteve pasi shfaqet fenomeni, dhe në bazë të shumicës së votave nga vendet anëtare. Pra denimi nuk është automatik por kërkon një vendim politik, i cili i vendos vendet anetare përpara një vendimi që mund të ketë kosto diplomatike. Pakti është shkelur disa herë nga disa vende anëtare; deficitit buxhetor në Portugali në vitin 2001 ishte 4.2% e PBB; ndërsa Gjermania dhe Franca parashikohen që deri në vitin 2006 të kenë një deficit buxhetor më të lartë se 3% e PBB.

Tabela 1. Niveli i Deficitit Buxhetor në % të PBB

	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Gjermani	-1.5	(-1.4)	-2.8	-3.6	-3.4	-2.9
Francë	-1.8	-1.4	-1.5	-3.1	-3.7	-3.5
Portugali	-2.8	-2.8	-4.2	-2.7	-3.5	-3.2

Sipas Creel (2003) dhe Buti (2003) një seri reformash e propozimesh paraqiten për të ndryshuar situatën korente të Paktit. Një nga këto propozime lidhet me aplikimin e “rregullit të artë të financave publike” në Bashkimin Evropian. Rregulli i artë i financave publike lidhet me kufizimin e nivelit të huamarrjes vetëm për të kryer investime publike. Një propozim i tillë është bërë edhe nga Ministri i Financave Italiane, M. Giulio Tremonti për të zbatuar një program investimesh publike në Europë me qëllim nxitjen

=====

e rritjes ekonomike, duke mos i përfshirë këto shpenzime në kriterin e deficitit buxhetor, pra aplikimin e “rregullit të arte”. Në fakt një politikë e tillë përdoret në Britaninë e Madhe dhe Australi.

Pra zgjedhja e politikës fiskale është në vartesi të kushteve ekonomike të vendit dhe gjithashtu përshtatet për të përmbushur objektivat kryesore të një vendi në periudha afatmesme dhe afatgjata. Situata ekonomike jo e favorshme mbi të cilën filloi ekonomia e tregut në Kosovë bie fjala, kërkonte një ndërhyrje të konsiderueshme nga ana e qeverisë në ofrimin e shërbimeve publike. Nivelet e ulta të të ardhurave për frymë, institucionet e dobëta, rënia e prodhimit ishin faktorë që e bënë të nevojshme financimin e shpenzimeve publike në një masë të konsiderueshme nëpërmjet huamarrjes.

Borxhet publike shfaqen pasi niveli i shpenzimeve të qeverisë është më i madh se niveli i të ardhurave të tyre korente.

Politika fiskale dhe politikat sociale

Zgjedhja e politikës fiskale, duhet të konsiderohet si një instrument i rishpërndarjes së pasurisë brenda një shoqërie dhe të sigurojë mbrojtje sociale.

Politika fiskale luan një rol të rëndësishëm në çështjet sociale të një vendi. Një vend me një nivel varfërie të lartë detyron qeveritë që një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga taksapaguesit të drejtohen në këto shtresa.

Të ardhurat nga taksapaguesit duhet të përdoren drejt, në mënyrë të paanshme dhe të jenë transparente, duke u bazuar më së shumti në burimin e të ardhurave nga kapitali, pasuria, fitimi dhe konsumi. Ky sistem duhet të jetë më shumë progresiv, me më shumë presion mbi kapitalin dhe pasurine, dhe duke reduktuar taksat mbi punën dhe mbi konsumin e popullatës. Një politikë e tillë do të bëjë të mundur të ndërtohet një sistem i fortë i mbrojtjes sociale, i aftë për një shpërndarje të drejtë sociale dhe në dobi të rritjes së mirëqenies të të gjithë popullsisë.

Politikat sociale duhet të bazohen si në shkallën e zhvillimit ekonomik ashtu edhe në strukturën demografike të vendit.

Zgjedhja e politikës fiskale në vendet ish-komuniste ka qenë tepër e vështirë, pasi kërkohej të arrihej njëkohësisht si rritje ekonomike, stabilitet makroekonomik, ashtu edhe financimi i shtresave sociale që goditeshin nga reformat strukturore. Në përgjithësi vendet ish-komuniste në fillim të tranzicionit të tyre u karakterizuan me një nivel barazie të lartë pavarësisht se niveli i të ardhurave për frymë ishte mjaft i ulët krahasuar me ato të vendeve të Evropës perëndimore. Zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve gjatë dekadës së fundit është shoqëruar edhe me rritje të nivelit të pabarazisë duke e bërë rolin e politikës fiskale në politikat rishpërndarëse me të nevojshëm.

=====

Sistemi i taksave progresive dhe politikat e transfertave drejt shtresave sociale vleresohen si instrumentat rishpërndarës më të mirë për peridhën afatshkurtër.

Politika e transfertave drejt shtresave sociale nuk mund të vleresohet si një politikë efiçente, pasi ajo nuk mund të ndryshojë gjendjen sociale të një individi. Subvencionet për përfitimet e papunësisë dhe ndihma ekonomike nuk kanë një ndikim të ndjeshëm në ndryshimin social të një personi. Politikat e transfertave mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen e mirqenies së këtyre shtresave për një periudhë të shkurtër kohe por ato nuk mund të konsiderohen si një burim që do të prodhojë mireqenie permanente për këto shtresa.

Një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varferisë luan kapitali human. Sipas Romer (1986) dhe Lucas (1998), kapitali human luan rol kryesor në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varferisë pra në zgjidhjen e problemeve sociale. Financimi i sektorit të arsimit dhe shëndetësisë nëpërmjet buxhetit të shtetit do të përmiresojë kapitalin human, i cili do të prodhojë rritje ekonomike dhe mireqenie. Ekziston një lidhje pozitive midis shpenzimeve në arsim e shendetesi me rritjen ekonomike e vertetuar nga një sërë kërkimesh.

Në një studim të Fondit Monetar Ndërkombëtar, është gjetur që shpenzimet publike në arsim dhe shëndetësi kanë një impakt direkt pozitiv në akumulimin e kapitalit arsimor dhe shendetësor, dhe një impakt indirekt negativ në rritjen ekonomike. Një rritje me 1% e PBB në shpenzimet e arsimit shoqërohet mesatarisht me tre vite shkolle më shumë duke ndikuar rritjen ekonomike me 1.4% në 15 vite. Ndërsa një rritje në shpenzimet e sektorit të shendetësisë me 1% e PBB shoqërohet me një rritje prej 0.6% në mbijetesën e fëmijëve nën 5 vjeç duke rritur rritjen ekonomike me 0.5% e PBB për frymë në vit.

Edhe në vendin tonë politika sociale ka qenë në vëmendjen e politikës fiskale që me fillimin e tranzicionit ku prodhimtaria ishte pothuajse inegzistente dhe papunësia u rrit ndjeshëm. Kjo situatë e detyroi qeverinë që të rrisë subvencionet për shtresat që u goditen më shumë nga ky ndryshim. Kështu nëpërmjet buxhetit të shtetit financohen si skema e pensioneve, ajo shëndetësore, transferime për pagesën e papunësisë, ndihma ekonomike dhe subvencione të tjera në dobi të shtresave sociale.

Politika fiskale dhe ekonomia sociale

Në fund të viteve shtatëdhjetë, një rrymë e re e quajtur "Ekonomiksi i krahut të ofertës" tërhoqi shumë vëmendje. Ofertistët janë të lidhur me disa ide të skajshme dhe të pamundura, si ideja se shkurtimi i normës së taksave

në SHBA do të ulë deficitin aq shumë sa norma e taksave të nxisë kaq shumë punë shtesë sa të rritet totali i taksave dhe të ulet deficitin.

Rreth kursimeve dhe investimeve, ofertistët argumentuan se sistemi i taksave në SHBA, shkurajon kursimet dhe individët do të kursenin më shumë në qoftë se përfitimet nga kursimet do të ishin më të larta.

Ata mbështesin taksa më të gjera të kredive të investimeve.

Sipas ofertistëve një normë më e ulët e taksave nxit sipërmarrjen private, duke argumentuar se rritja mund të rritej nëpërmjet politikave të ndërtuara për të nxitur eficiencë më të madhe, një dëshirë më të madhe për punë dhe investime, produktivitet më të lartë.

Sipas kësaj rryme një shkurtim në nivelin e taksave do të çojë në rritjen e të ardhurave, dhe kështu nuk do të kemi rritje të deficitit buxhetor (sipas kurbes Laffer).

Boshti horizontal tregon të ardhurat nga taksat, boshti vertikal normën e taksës




Figura 3: Kurba e Lafferit

Siç shihet nga figura të ardhurat nga taksat janë rritur deri në një nivel të caktuar të normës së taksës dhe me pas kanë filluar të bien.

Ekonomistët e krahut të ofertës argumentojnë që efekti inkurajues i shkurtimit të taksave është aq i madh sa që do të prodhojë rritje të të ardhurave për shkak të rritjes së bazës së taksueshme.

Një nga debatet më të shpeshta në sferën politike, sidomos gjatë periudhave të zgjedhjeve elektorale, fokusohet në sistemin e taksave.

Platformat elektorale që bazohen në ndryshimin e nivelit të taksave janë të prekshme, dhe zakonisht partitë që janë në opozitë prezantohen me

=====

sisteme me norma më të ulta taksash në qoftë se ato vijnë në pushtet. Faktikisht, platformat që janë bazuar në uljen e taksave nuk kanë rezultuar të suksesshme.

Argumentet teorike të kësaj rryme nuk janë vërtetuar në praktikë.

Përdorimi i këtyre ideve nga Reagan në vitin 1981 (i cili ishte një nga përkrahësit e ekonomisteve të krahut të ofertës) me shkurtim taksash, u shoqërua me rritje të deficitit buxhetor. Ndikimi në rritjen e kursimeve private dhe në rritjen e ofertës për punë ishte minimal, oferta për punë nuk u rrit dhe efekti në kursimet private u eliminua nga reduktimi në kursimet publike (rritje e deficitit buxhetor). Përderisa oferta për punë nuk u rrit dhe kursimet pësuan një rritje të vogël, të ardhurat buxhetore nuk pësuan rritje. Hipoteza e kurbes Laffer dështoi, bashke me përkrahësit e krahut të ofertës.

Ekonomistët e krahut të ofertës u shfaqën përsëri në kohën e Bill Clinton, në vitin 1993, kur ai paraqiti planin e reduktimit të deficitit buxhetor. Edhe pse gjatë viteve 1990 u ndoqën politikat e krahut të ofertës, deficitit buxhetor u rrit nga 2.7% e PBB në 1980 në 4.9% e PBB në vitin 1992, dhe borxhi publik nga 26.1% e PBB në 1979 në 50.6% e PBB në vitin 1993. Plan i shkurtimit të deficitit të Clintonit ishte bazuar në një rritje të caktuar të taksave mbi të ardhurat (vetëm për shumë të pasurit), një rritje në disa nga taksat indirekte dhe një ulje të ritmit të rritjes së shpenzimeve qeveritare.

Përkrahesit e rrymës së krahut të ofertës kritikuan që rritja në normën e taksave do të:

1. ndihmojë ekonominë që të shkojë në rënie dhe do të reduktojë rritjen ekonomike afatgjate;
2. rrisë deficitin buxhetor pasi individët do të reduktojnë ofertën e punës dhe kursimet;
3. rrisë normën reale të interesit për shkak të rritjes së deficitit buxhetor.

Në fakt efektet e planit të reduktimit të deficitit buxhetor të prezantuar nga Clinton ishin plotësisht të kundërta me ato çka paraqitën predikuesit e krahut të ofertës:

1. Deficiti buxhetor u reduktua nga 4.9% e PBB në vitin 1992 në 1.2% e PBB në vitin 1996, ndërsa norma e borxhit publik ishte në rënie;
2. Ekonomia përballi një rritje në vitet 1993-1994 pas recesionit të vitit 1990-91 dhe ekonomia u rrit me një normë mesatare prej 2.8% gjatë viteve 1992-96;
3. Norma e interesit mbeti e qëndrueshme duke arritur në 2% në vitin 1996 (instrumentet afatshkurtër) krahasuar me 5% që ishte në vitin 1980.

=====

Këto pikëpamje u shfaqën përsëri në Amerike në vitin 1996 nga Steve Forbes i Partise Republikane.

Ai propozoi: ndryshimin e sistemit progresiv të taksave mbi të ardhurat në një sistem më një norme të dhënë takse (flat). Sipas këtij propozimi, një sistem taksash me një normë të vetme do të ndikojë në rritjen e produktivitetit të punës duke stimuluar ofertën e punës, kursimet dhe investimet.

Në qoftë se një gjë e tillë do të ndodhë atëherë rritja ekonomike do të rritej nga një mesatare prej 2.5% në vit gjatë viteve 1990 në 4-5% në vit.

Por këto parashikime mbi dyfishimin e rritjes ekonomike janë të papranueshme nga ekonomistët, edhe kur ndodhin ndryshime të politikave ekonomike.

Kjo për arsye se ekonomistët nuk ngatërrojnë ndikimin në nivelin e PBB me ndryshimet në nivelin e rritjes ekonomike. Ekziston një ndryshim i madh midis politikave që ndikojnë nivelin e PBB nga ato që ndikojnë nivelin e normës së rritjes së PBB.

Është e pranueshme që efektet e ndryshimit të politikës së taksave në SHBA do të ndikojnë në nivelin e PBB, por është e vështirë të provohet ndikimi i kësaj politike në normën e rritjes afatgjate. Për rrjedhojë ndryshimi i politikës së taksave të propozuar nga Forbes nuk çon në dyfishimin e rritjes ekonomike nga 2.5% në 5%.

Shkurtimi i taksave gjatë viteve 1980 në SHBA konfirmuan që nuk ekziston ndonjë efekt permanent në normën e rritjes ekonomike.

Megjithatë Robert Barro, një nga udhëheqësit e ekonomisteve konservativ është shprehur se kalimi në një sistem taksash flat pa ndryshime në shpenzimet qeveritare, do të stimulojë rritjen ekonomike, por ky efekt është i vështirë për tu matur.

Një shkurtim në shpenzimet joproduktive dhe taksa me 1% të PBB do të çojë në rritjen e rritjes ekonomike me 0.1% në vit.

Në qoftë se taksat bëhen me pak shtrënguese, pra nuk eliminohen, efekti në rritje do të jetë më i vogël (maksimumi do të përgjysmohet).

Pra edhe sipas Barro, vendosja e një norme konstante takse për të gjithë konsumatorët nuk do të sjellë rezultatet e pritura nga ekonomistët e krahut të ofertës.

Debatet politike, për shembull, që bazohen në shkollën e ndryshme të mendimit ekonomik paraqiten edhe në platformat elektorale në prag të zgjedhjeve elektorale në Shqipëri.

Një nga propozimet më të debatueshme nga opozita në prag të këtyre zgjedhjeve është ulja e taksave dhe me konkretisht mos tatimi i bizneseve të reja (bizneset e vogla) për një periudhë tre-vjeçare sepse mendojnë që kjo masë do të rrisë prodhimin.

=====

Por bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës sepse bizneset ekzistuese do të jenë në pozita inferiore karshi bizneseve të reja. Një situatë e tillë do të prishte parimet e tregut duke krijuar çekuilibrim. Mostatimi i bizneseve të reja (bizneset e vogla) do të bie ndesh me parimin e thjeshtësisë të sistemit tatimor. Në mënyrë që bizneset të fitojnë nga ky përjashtim, ata mund të mbyllin biznesin egzistues duke e rihapur nën një emer të ri.

Vleresimet empirike të vitit 2003 tregojnë që për çdo 1 përqind shkurtim të takses mbi biznesin e vogel efekti në të ardhurat buxhetore është 450 milion lekë(bëhet fjalë për Republikën e Shqipërisë). Kombinuar kjo me abuzimet që do të vijnë nga aplikimi i mostatimit për tre vitet e para efekti në të ardhurat buxhetore parashikohet të arrijë në rreth 2 miliard lekë.

Në paketen fiskale të vitit 2005, Qeveria Qendrore e Republikë së Shqipërisë propozoi që të ulëj niveli i tatimit mbi biznesin e vogël, e cila nuk u pranua nga Qeverisja Vendore.

Rëndësia e taksave

Në bazë të të ardhurave tatimore hartohen politikat fiskale.

Termi politikë fiskale i referohet shpenzimeve që kryen një qeveri për të ofruar të mira e shërbime dhe mënyrës se si qeveria financon këto shpenzime. Ekzistojne dy metoda kryesore te financimit: nëpërmjet taksimit dhe nepermjet huamarrjes. Metoda e huamarrjes rezulton me kosto të larta dhe në disa raste me pamundësinë e shqyerjes, kështu që metoda e taksimit është me e thjeshta, me efikase dhe siguron të ardhura në masë të madhe në bazë të fuqisë të shtetit për mbledhjen e këtyre taksave.

Pra sistemi tatimor përbën burimin primar të të hyrave të shtetit, ato përbëjnë 50 % të të hyrave publike që janë thelbësore për mbarëvajtjen e një shteti demokratik.

Duke u ndërtuar në mënyre të drejtë dhe në mënyrë eficiente sipas normave legjislative, i sigurojnë shtetit mjetet e nevojshme për plotësimin e funksioneve të tij dhe për arritjen e objektivave të tij fiskale.

Përmirësimet që po i bëhen sistemit të taksave, si në anën e ndërhyrjeve në ligje ashtu edhe në administrimin e tyre, do të shoqërohen me efekte pozitive në rritjen e prodhimit. Ulja e normës së tatimit mbi fitimin nga 25% në 20% në vitin 2006 ndikon në rritjen e kursimeve të korporatave duke rritur kështu edhe investimet në ekonomi.

Zgjedhja e politikës se taksave, ndihmon në rishpërndarjen e pasurisë brenda një shoqërie dhe siguron mbrojtje sociale. Një vend me një nivel të lartë varfërie detyron qeveritë që një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga taksapaguesit të drejtohen në këto shtresa. Kjo do të thotë që qeveritë nuk duhet t'i formulojnë politikat e tyre vetëm në dobi të tregjeve financiare, por të jenë funksion i vlerave sociale të përcaktuara në mënyrë

=====

demokratike. Në një sistem të tillë, të ardhurat nga taksapaguesit duhet të përdoren drejt, në mënyrë të paanshme dhe të jenë transparente, duke u bazuar më së shumti në burimin e të ardhurave nga kapitali, pasuria, fitimi dhe konsumi. Ky sistem duhet të jetë me shumë progresiv, me më shumë presion mbi kapitalin dhe pasurinë, dhe duke reduktuar taksat mbi punën dhe mbi konsumin e popullatës.

Sistemi i taksave progresive dhe politikat e transfertave drejt shtresave sociale vleresohen si instrumentat rishpërndarës me të mirë për peridhën afatshkurter.

Politika fiskale dhe roli i politikës

Zgjedhja e një politike fiskale të caktuar, është një nga treguesit që e klasifikon një qeveri si të majtë apo të djathtë.

Një qeveri është quajtur e majte në qoftë se kërkon të sigurojë shërbime publike duke shpenzuar më shumë për arsim dhe shëndetësi.

Në lidhje me sistemin e taksave këto qeveri mendojnë të mbajnë nivele të larta të taksave mbi të ardhurat për të mbuluar këto shpenzime qeveritare.

Qeveritë e majta pëlqejnë që të mbajnë nivele të ulta të taksave indirekte për arsye se ato janë regresive dhe kështu që prekin më pak të pasurit.

Qeveritë e djathta kërkojnë të reduktojnë shpenzimet qeveritare sa me shume të jetë e mundur. Qeveritë e djathta inkurajojnë skemat private të kujdesit shëndetësor dhe të arsimit privat. Në lidhje me taksat qeveritë e djathta mendojnë të mbajnë nivele të ulta të taksave mbi të ardhurat sepse sipas tyre taksat frenojnë sipermarrjen private.

Këto qeveri kërkojnë kalimin nga taksat direkte te ato indirekte.

Rezultatet e studimit të kryer nga Pettersson-Lidbom (2003) bazuar ë të dhenat e qeverisjes vendore suedese, treguan që roli i partive politike është i rëndësishëm. Qeveritë e majta shpenzonin dhe taksonin 2.5 përqind më shume sesa qeveritë e djathta. Sipas Tavers (2004) tregon që pershtatjet fiskale midis qeverive të majta dhe të djathta ndryshojnë; te majtet mbeshteten në rritje taksash, ndersa të djathtet në shkurtim shpenzimesh. Studimi i Tavers (2004) mbeshtet hipotezen që të majtët janë më shumë të besueshëm sesa të djathtët kur shkurtojnë shpenzimet (shpenzimet totale si konsumin publik dhe komponentët e tij), dhe të djathtët janë më shumë të besueshëm kur rritin taksat (taksat në përgjithësi dhe taksat direkte mbi biznesin). I vështirë mbetet klasifikimi i politikës fiskale në vendin tonë. Për shkak të ristrukturimit të ekonomisë si pasojë e kalimit nga ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu, zgjedhja e një politike fiskale të caktuar i përgjigjet gjendjes aktuale të ekonomisë.

Pasiguria politike në vend dhe mungesa e stabilitetit social ka çuar në politika të paqendrueshme që kanë ndikuar negativisht në ciklet e biznesit.

Literatura

1. "Leksione të Shkencës së Financës" Mario Leccisotti.
2. "Makroekonomi" Rudiger Dornbusch & Stanley Fischer.
3. "Financa Publike" Harvey S. Rosen. Tiranë. Albin 2003
4. Fondi Monetar Ndërkombetar. Challenges to reforming Tax Administration. May 2005
5. "Financat Publike" Prof.As.Dr. Beatrice Polo. Tiranë. Albpaper 2002.
6. Website. www.google.com
7. "The Politics of Tax Structure" Working Paper. Steffen Ganghof, January 2006
8. Alvaro Riascos Banco and Carlos A. Vegh "Procyclical Government Spending in Developing Countries: The Role of Capital Market Imperfections" IMF Working Paper, 2003.
9. Ames, B., Brown, W., Devarajan, Sh., and Izquierdo, A. "Macroeconomic Policy and Poverty Reduction" IMF and World Bank, 2001.
10. Dong Fu, Lori L. Taylor, Mine K. Yücel "Fiscal policy and growth" Federal Reserve Bank of Dallas, Working Paper 0301, 2003.
11. Durmus Özdemir "Growth, Infrastructure and Fiscal Policy". Istanbul Bilgi University, 2003.
12. Jose' Tavares, "Does right or left matter? Cabinets, credibility and fiscal adjustments", Journal of Public Economics 88 (2004) 2447– 2468
13. Milner, Helen. and Benjamin Judkins. "Partisanship and Trade Policy: Is There a Left-Right Divide on Trade Policy?", Columbia University,
14. Philipp C. Rother "Fiscal Policy and Inflation Volatility" European Central Bank, Working Paper no. 317, 2004
15. Per Pettersson-Lidbom "Do Parties Matter for Fiscal Policy Choices? A Regression-Discontinuity Approach" Department of Economics, Stockholm University, 2003.
16. Dokumenta dhe materiale te Ministrise se Financave, Bankes Boterore dhe Fondit Monetar Nderkombetar.

=====